

FJALA E DEPUTETIT FATIION VEIZAJ

E ENJTE 24 SHKURT 2022

Të nderuar kolegë,

Kam përshtypjen se mënyra se si po funksionon administrata ka mbërritur në atë pikë të mungesës së përgjegjshmërisë ligjore, sa mund të flitet pa frikë për anarki. Anarkia nuk është rastësi, por pasojë e një strukture marrëdhëniesh, e një vizioni politik që funksionon me një qendër, e një ideje fikse që është pronë e udhëheqjes dhe jo platformë publike. Që të gjithë varen nga kjo ide, nga nënshtrimi pa kushte ndaj saj e ndaj krijuesit të saj. Kjo e shndërron qeverisjen në autokraci. Ky është peshqeshi i 25 prillit. Produkti me spektakolar i kësaj fryme është jashtë çdo dyshimi afëra skandaloze e inceneratorëve. Shihni bazën e kësaj skeme banale: në një rën anë artikullohet ideja e pastrimit të Shqipërisë, që është ideja udhëheqëse, ndërsa mbi të në praktikë kompani anonime shfaqen e turren për të rrëmbyer e zhvatur në emër të saj. E gjithë retorika e Kryeministrit dhe e shpurës së tij fshihet pas kësaj ideje, pas kësaj domosdoshmërie purifikuese, që vetëm kjo qeveri pati vizionin t'i përgjigjet, siç thonë shërbëtorët e paguar të pushtetit. Në fakt, rekorde si ky janë vërtet të panjohura në historinë dramatike të qeverisjeve në Shqipëri. Kurrë më parë nuk ka pasur një miks kaq agresiv dhe kaq të hapur grupesh të interesuara për të zhvatur fondet publike. Kurrë më parë, besoj, nuk ka pasur njerëz me kurajën morale, të përfshirë në këtë aferë, që të guxojnë ta shpallin veten të persekutuar dhe të bullizuar kundrejt asaj opozite që është e panënshtuar kundër tyre.

Këta njerëz pa një grimë vetëdijeje, pa një grimë përgjegjësie shtetërore, kanë fytyrë të akuzojnë, të përbuzin, të kërcënojnë, t'i quajnë të tepërta shpjegimet, të ndihen të fyer, sepse dikush i afrohet filluskës së tyre të paprekshme. Populli shqiptar, publiku, siç e tregon sjellja e tyre përballë komisionit, në rastin më të mirë është një tufë njerëzish pa qëllime, që këta i kanë lidhur me një rrjetë të pafundme kodesh, ligjesh, udhëzimesh, lëshimesh, patronazhistësh, e çfarëdolloj demagogjie pa din e iman. E shumta, populli duhet të mirëkuptojë qëllimin e mirë të inceneratorëve, paçka se janë vjedhur miliona pa fund. Ky është vetëm një aksident që mund t'i ndodhë kujtdo e të ndodhë kudo. Por ky skandal nuk është as rastësi dhe as përjashtim, e kundërta duhet të na habisë. Domethënë, u bënë vite, ku është e pamundur që në këtë moçal pislëku të gjesh diçka të pastër. Punizmi e çdo variant tjetër autokratik po mbjell mafien në qeverisjen e vendit. Praktika e ndërtimit dhe e financimit të inceneratorëve është rast tipik i veprimtarisë mafioze, kur një grup, në bashkëpunim, me vetëdije, me planifikim, me sigurinë e mbështetjes politike, shfrytëzon mjete financiare e burime të tjera shtetërore, futet në sistemin e administrimit publik, e kontaminon atë në atë farë feje, sa është e vështirë të ndash se ku mbaron politikani e ku fillon mafiozi. Grupi ka siguruar sponsorët e pushtetit, ka krijuar kauzën publike apo ka shfrytëzuar informacionin, që, natyrisht, nuk është për këdo, dhe me të gjithë arrogancën e përbuzjen për qeverisjen normale, me gjithë vetësigurinë që të jep forca e 25 prillit, i ka hyrë pangopësisht vjedhjes. Asgjë nuk e pengon, përkundrazi.

Retorika idealiste e udhëheqjes vihet në funksion të vjedhjes, individë anonimë shfaqen nga hiçi, rrëmbejnë miliona dhe zhduken, ndërsa udhëheqja mban përgjegjësi vetëm për idenë e pastrimit. Kjo është shumë e trashë, shumë e trashë, në qoftë se do vazhdojë të përdoret si argument. Kjo elitë qeverisëse nuk ka asnjë lidhje me idealizmin, përkundrazi, në historinë e Shqipërisë do të mbahet mend si uzurpimi më i paturpshëm e grabitqar i aspiratës popullore për zhvillim. Ajo ka degraduar,

sepse pothuaj të gjithë mekanizmat e saj janë kompromentuar aq shumë, sa nuk mund të përdoren më. Nuk bëjnë më për asgjë, përveçse i shërbejnë inercisë vdekjeprurëse të 25 prillit. Pushteti e ka ndierë këtë traumë që sa vjen e bëhet gjithmonë e më e rëndë për themelet e tij, aq sa përpigjet me improvizime hipokrite, si për shembull, “Këshillimi Kombëtar për Hashashin”, të fshehtë mekanizmin e vetëm që e mban atë në këmbë: kontrollin, shantazhin mbi shoqërinë, pa përjashtim mbi këdo. Le të shohim Vlorën. Aty po ndodhin ca zhvillime sa të dukshme, edhe të padukshme, të gjitha jashtë marrëveshjes publike. Të padukshmet i di udhëheqja, por e çuditshmja është se edhe ato të dukshmet, ta zëmë ndërhyrjet infrastrukturore, janë të paqarta në funksionin e tyre, në marrëdhënien e tyre me qytetin. Hapësira të reja absurde, trajta betoni, për të cilat askush nuk di asgjë, shfaqen prej hiçit, rindërtojnë, fshijnë pa mëshirë kujtesën e qytetit. Ç’po ndodh në sheshin përpara bashkisë? Një Zot misterioz e di. Si do të organizohet itinerari i pashmangshëm i lëvizjes masive të banorëve që hyjnë çdo ditë në qytet nga Lumi i Vlorës, i funeraleve, i urgjencave spitalore, që të gjitha do të pleksen në një bërryl? Bëhet fjalë për nyje jetike për ritmin e jetës në qytet. Vlora ka probleme me trafikun fare pa arsye.

Një djalë i ri 21-vjeç ndoshta do të kishte shpëtuar, nëse ndihma e shpejtë nuk do të hiqej zvarrë nëpër rrugicat që zëvendësuan bulevardin apo nëpër Lungomare. Nuk dua të spekuloj me fatkeqësinë, por për vlonjatët disa nyje trafiku janë kthyer në ankth të përditshëm. Çfarë po ndodh me Sheshin e Flamurit? Nëse rindërtimi i platformës për Monumentin e Pavarësisë ia vlente, përse aty po krijohet një labirint i zyrtë betoni, kur mund të bëhej një ndërhyrje që mund të sillte hapësirë për një shesh kombëtar? Çfarë po ndodh me hotelin mbi shesh? A ka ndonjë ndryshim që duhet njoftuar për publikun? Ç’po ndodh në Skelë? Aty eksperimenti urban është edhe më i çuditshëm. Një kompleks misterioz e grotesk po e veçon dhe fshehtë simbolin e këtij shteti, Shtëpinë e Pavarësisë, nga qyteti, që, për hir të së vërtetës, vendndodhjen nuk e ka pasur aty. Ç’po ndodh me traqetin e udhëtarëve, në intervalin gjatë zhvendosjes së portit të mallrave në Triport? Ç’po ndodh me Kaninën e përbuzur e të harruar? Me tokat e landfillit të Sherishtës, të ndërtuar në tokat e 60 familjeve të Kaninës ende të pashpronësuar? Ka një plan për ndërtimin e një inceneratori atje, meqë edhe ky landfill është pjesë e monopolit të Zotos. Meqë ra fjala, landfilli ende nuk ka nisur nga puna, por në janar të këtij viti bashkia e Vlorës ka disbursuar 110 milionë lekë të rinj për trajtimin e mbetjeve atje. Çfarë do të bëhet me projektin e bajpasit që Kaninën e ka lënë pa hyrje - dalje, pa mbikalime e nënkalime drejt tokave bujqësore? Për të ardhur nga Kanina në drejtim të Vlorës, banorët dhe drejtuesit e automjeteve duhet të futen në sens të kundërt kalimi, duke rrezikuar veten.

Të nderuar kolegë, Vlora është një ekzemplar i rrallë për mënyrën private e konspirative të qeverisjes dhe le ta mbajmë parasysh se unë po flas për gjëra të thjeshta e të dukshme, atje askush nuk di asgjë, të gjithë e pësojnë, askush nuk flet. Qyteti jeton nën një omertë të frikshme. Këto ishin disa pyetje, që mund të marrin përgjigje, pa dyshim, por e keqja tashmë është bërë. Edhe me keq akoma, kjo që po ndodh në Vlorë, do të përparojë dhe do të thellohet. Është e qartë se ndërtimi i qyteteve private, pa marrëveshje, pa miratim publik, nën konspiracion, me ndikim zero, ose me ndikim përkeqësues për jetën e banorëve, nuk është ndërmarrje pa qëllim, nuk është aventurë, por është shenjë, është vullnet i zotëruesit arrogant të jetës, pronës e të ardhmes së qytetareve. Domethënë, ne jemi në shtëpinë e tij, jo në tonën, jetojmë sipas rregullave të tij dhe jo në lirinë e marrëveshjeve publike në të mirë të të gjithëve. Besoj se kjo është arsyeja kryesore e arratisë nga Shqipëria. Anarkia është e pashmangshme po aq edhe dëmi që po krijon për të ardhmen pa identitet, pa bosht, pa moral, në varfëri, pasiguri, vetmi e depresion social. Paratë e trafiqeve janë e vetmja zgjidhje e mjerë dhe e përkohshme. Në fund, e mira e gjithë kësaj është se zullumi është trashur dhe është majmur, sa nuk do shumë që të këputet.